

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.84/2022	Data: 31.05.2022	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008), neni 27 i Ligjit Nr. 04/l-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 03/l-221, dhe neni 33.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2022 shqyrtoi dhe miratoi propozimit e kryetarit të Komunës për ndarjen e buxhetit dhe tejkalimin e THV 2021 dhe mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E BUXHETIT DHE TEJKALIMIN E THV 2021

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për ndarjen buxhetore dhe tejkalimin e THV 2021, si dhe për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2021 për shpenzim në vitin fiskal 2022, në vlerë prej: 304,132.55 €, si në vijim:

- I. Shuma totale e të hyrave vetanake të inkasuar në periudhën Janar – Dhjetor 2021 duke përfshirë të gjitha të hyrat është: 304,132.55 €, shuma e planifikuar për vitin 2021 është 1,074,179.00 €, ku shihet se kemi tejkalim të inkasimit të të hyrave vetanake për vitin 2021 në vlerë prej: 171,653.50 €, në këtë shumë janë të përfshira edhe gjobat e trafikut.
- II. Total shuma prej 304,132.55 €, të bartet si në vijim:

1. Kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime:

- Shuma prej 37,809.01 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Mallra dhe Shërbime, në programin Administrata dhe Personeli me kod 163, në nën programin Administrata me kod 16317.


 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Uqles-Izlazna

Nr: 633-45 Data: 08.06.2022
 Istog-Istok

2. Kategoria ekonomike Shpenzime Kapitale :

- Shuma prej 11,735.00 €, të bartet në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale, në projektin me kod 50946 **"Asfaltimi i rrugës Arif Ademi në Banjë**, vazhdim i projektit nga viti 2021, në programin Zyra e Komiteteve me kod 195, në nën programin Zyra komunale për komitete dhe kthim, me kod 19585.
- Shuma prej 44,390.00 €, të bartet në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale, në projektin me kod 50948 **"Ndërtimi i rrugës Rozhaja në Banjë**, vazhdim i projektit nga viti 2021, në programin Zyra e Komiteteve me kod 195, në nën programin Zyra Komunale për Komitete dhe Kthim, me kod 19585.
- Shuma prej 10,000.00 €, të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime Kapitale, për projektin **"Ndërtimi i kanalit të ujitjes "Jazi i Madh" në Istog të Poshtëm**, projekt i ri, në programin Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me kod 470, në nën programin Bujqësi, me kod 47017.
- Shuma prej 16,658.60 €, të bartet në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale, në projektin me kod 50927 **"Betonimi i Kanalit te Lubeniqeve-Tomoc,,** vazhdim i projektit nga vitit 2021, në programin Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me kod 470, në nën programin Bujqësi, me kod 47017.
- Shuma prej 28,852.45 €, të bartet në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale, në projektin me kod 50940 **"Betonimi i Kanalit te ujitjes Lagja Balaj-Lluga**, vazhdim i projektit nga vitit 2021, në programin Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me kod 470, në nën programin Bujqësi, me kod 47017.
- Shuma prej 35,000.00 €, të bartet në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale, në projektin **"Platforma E-bujku**, projekt i ri, në programin Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me kod 470, në nën programin Bujqësi, me kod 47017.
- Shuma prej 34,652.82 €, të bartet në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale, për projektin me kod 46291 **"Ndërtimi i rrugëve në Vrellë"**, në programin Zhvillim Ekonomik me kod 480, në nën programin Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik, me kod 48017.

- Shuma prej 60,000.00 €, të bartet në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale, për projektin **"Ndërtimi i rrugëve "Rexhë Destani, Berati dhe Hasan Prishtina" në Istog**, projekt i ri, në programin Zhvillim Ekonomik me kod 480, në nën programin Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik, me kod 48017.
- Shuma prej 25,034.67 €, të bartet në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale, për projektin **"Ndërtimi i rrugës në Lagjen "Hajrizaj" në Zhakovë**, projekt i ri, në programin Zhvillim Ekonomik me kod 480, në nën programin Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik, me kod 48017.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesën: Drejtori për Shërbime Publike, Drejtori për Arsime dhe Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport,

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Ministra e Financave, Punës dhe Transferit, Kryetari i Komunës, Drejtori për Buxhet e Financa, Zyrtari kryesor Financiar (ZKF) dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit të Komunës së Istogut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

